



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3083/17 prot.

Datë 24.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 87/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1376/2023, datë 28.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK me NIPT L42004007D dhe adresë: Tiranë, Kamëz, Bathore, Rruga “Ismail Qemali”, pikë tregtimi lëndësh drusore me nr. Pasurie 192/49, zona Kadastrale 2066, afër Kuvendi i Junikut

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mirditë me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen

**Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Xheksoni-04” SHPK me NIPT K39010090G dhe adresë: Rrëshen, SHESHAI, Lagjja "Nokaj", banesë private 2-katëshe nr.4, kati parë

Operatori ekonomik Gjergj Buça p.f me NIPT K31331547R dhe adresë: Durrës, DURRES, Ura Dajlanit

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 08.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 15/2024 ku vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.*
- 2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 1376/2023 datë 28.12.2023 të KPP-së.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 241 prot., datë 18.01.2024 protokolluar me tonën nr. 3083/14 prot., datë 19.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1376/2023 datë 28.12.2023.

I.3. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dorëzuar bashkëlidhur shkresës procesverbalin e datës 10.01.2024 “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” Objekti i procedurës: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 241 prot., datë 18.01.2024 protokolluar me tonën nr. 3083/14 prot., datë 19.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1376/2023 datë 28.12.2023.

II.2. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dorëzuar bashkëlidhur shkresës procesverbalin e datës 10.01.2024 “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” Objekti i procedurës: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë referuar përmbajtjes së procesverbalit të datës 10.01.2024 “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” Objekti i procedurës: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë” e ka zbatuar vendimin nr. 1376/2023 datë 28.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
  2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

